



Republika e Kosovës



Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës
Ured Predsednika Republike Kosova
Office of The President of the Republic of Kosova

PRESIDENTI SEJDIU NË DITËN E PAVARËSISË
DHE FILLIMIN E BEKIMIT NDËRKOMBËTAR
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Përgatitur nga Zyra për Informim e Presidentit të Republikës

Digajn: Ferim Matoshi

www.president-ksgov.net

Presidenti i Republikës së Kosovës,
Prof. Dr. Fatmir Sejdiu nënshkruan i pari Deklaratën e Pavarësisë



Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

Të mbledhur në mbledhje të jashtëzakonshme më 17 shkurt 2008, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë,

Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afiron krenarinë dhe synimet e qytetarëve të saj,

Të zotuar për t'u përballur më trashëgiminë e dhembshme të së kaluarës së afërt në fryshtë të pajtimit dhe faljes,

Të përkushtuar ndaj mbrojtjes, promovimit dhe respektimit të diversitetit të popullit tonë,

Duke riafirmuar dëshirën tonë për t'u integruar plotësisht në familjen euroatlantike të demokracive,

Duke vërejtur se Kosova është një rast special që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është presedan për cilendë situatë tjetër,

Duke rikujtuar vitet e konfliktit dhe dhunës në Kosovë që shqetësuan ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar,

Mirënjoës që bota intervenoi më 1999 duke hequr në këtë mënyrë qeverisjen e Beogradit mbi Kosovën, dhe vendosur Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara,

Krenarë që Kosova që atëherë ka zhvilluar institucionale funksionale, multietnikë të demokracisë që shprehin lirisht vullnetin e qytetarëve tanë,

Duke rikujtuar vitet e negociatave të sponsorizuara ndërkombëtarisht ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mbi çështjen e statusit tonë të ardhshëm politik,

Duke shprehur keqardhje që nuk u arrit asnjë rezultat i pranueshëm për të dyja palët përkundër angazhimit të mirëfilltë të udhëheqësve tanë,

Duke konfirmuar se rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, i ofrojnë Kosovës një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e saj të ardhshëm, dhe janë në vijë me standartet më të larta europiane për të drejtat të njeriut dhe qeverisjen e mirë,

Të vendosur që ta shohim statusin tonë të zgjidhur në mënyrë që t'i jipet popullit tonë qartësi mbi të ardhmen e vet, të shkohet përtej konflikteve të së kaluarës dhe të realizohet potenciali i plotë demokratik i shoqërisë sonë,

Duke nderuar të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën,

1. Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

2. Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnikë, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtës së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

3. Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjisacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

4. Ne do të miratojmë sa më shpejt që të jetë e mundshme një kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definohen me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.

5. Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Europian. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitet që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të janë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht më këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë.

6. Për arsyen e kulturës, gjeografisë dhe historisë, ne besojmë se e ardhja jonë është në familjen europiane. Për këtë arsyen, ne shpalim synimin tonë për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin European apo që të jetë e mundshme dhe për të zbatuar reformat e kërkua e përgjegjësieve e integrimit europian dhe euroatlantik.

7. Ne i shprehim mirënjojhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas lufte dhe ndërtimin e institucioneve të demokracisë. Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me Organizatën e Kombeve të Bashkuara gjersa ajo vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.

8. Me pavarësinë vie detyra e anëtarësisë së përgjegjishme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë dhe do t'i përbahemi parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit, akteve tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhëni ndërmjet shteteve. Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtarë ashtu siç janë paraparë në Aneksin VIII të Planit të Ahtisaarit, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të të gjithë fqinjve tanë. Kosova, po ashtu, do të përbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jokonsistente me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

9. Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstitutive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëni diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

10. Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Europës Juglindore. Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që

do të lejonte Europën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit. Për këtë arsyen, do të punojmë së bashku me fqinjtë tanë për të avansuar të ardhmen tonë të përbashkët europiane.

11. Ne shprehim, në veçanti, dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjtë tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike, tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë më tej në të ardhmen e afërt. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'i kontribuar marrëdhënieve të fqinjësise dhe bashkëpunimit me Republikën e Serbisë duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.

12. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të quartë, specifike dhe të parevokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitat e përbajtura në këtë Deklaratë, përsfirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.



Kërkesa e Presidentit Sejdiu dhe Kryeministrit Thaçi për seancë të jaftëzakonshme të Kuvendit të Kosovës



Presidenti i Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, me bashkëpunëtorët e tij, në Ditën e Pavarësisë, bëri homazhe te varri i Presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova.

Presidenti Sejdiu për Presidentin Rugova

Prishtinë, 17 shkurt Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu në prag të shpalljes së pavarësisë së Kosovës sot bëri homazhe pranë Memorialit të Presidentit Rugova.

"Kishim një përkujtim të gjithmonshëm për Presidentin Rugova, për themeltarin e shtetit modern të Kosovës për njeriun që sakrifikoi vetën në kohët më të vështira dhe u shkri për Kosovën, për njeriun që vuri parimet e demokracisë dhe pluralizmit në Kosovë, për njeriun që na ofroi në mënyrën më të mirë me botën demokratike dhe siguroi miqtë më të fortë për Kosovën, për njeriun që diti të artikulojë më së miri në kohën e vet në shekullin e vet idenë për lirinë, pavarësinë dhe demokracinë e Kosovës", theksoi Presidenti Sejdiu.

"Është nder i veçantë për të gjithë ne, për të gjithë brezat që dhanë jetën e vet që në binomin e veçantë të Ibrahim Rugovës dhe Adem Jasharit kanë simboliken e përjetësisë", theksoi Presidenti Sejdiu.



Presidenti i Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, me bashkëpunëtorë, vizitoi familjen e Presidentit Rugova.



Presidenti i Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, me bashkëpunëtorët e tij, në ditën e pavarësisë, bëri homazhe te varri i komandantin të UÇK-së, Adem Jasharit.



Presidenti Sejdiu dhe Rifat Jashari në Ditën e Pavarësisë



Presidenti i Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu vuri lule të freskëta për të nderuar të pagjeturit e Kosovës.



Fjala e Presidentit Sejdiu në Kuvendin e Kosovës

Fjala e Presidentit Sejdiu në Kuvendin e Kosovës në ditën e shpalljes së Pavarësisë

Inderuar Kryetar i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi,
Inderuar Kryeministër i Kosovës, z. Hashim Thaçi,
Të nderuar deputetë dhe ministra,
Enderuara familje e Presidentit Rugova,
Enderuara familje Jashari,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të misioneve diplomatike në Kosovë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Poštovani poslanici,
Poštovani gradjani Kosova,
Zonja dhe Zotérinj.

Dita e sotme e ndan historinë e Kosovës në dysh: në epokat para dhe pas pavarësisë. Pavarësinë e Kosovës e kanë krijuar brezë të tërë me veprën e tyre jetësore, me punë të palodhshme dhe me sakrifitat që kanë bërë. Pavarësinë tonë po e shpallim para dhe me bekimin e botës, në mes miqsh tanë që u gjetën pranë nesh gjatë dekadave e sidomos para një dekade kur e keqja kishte

përfshirë këtë pjesë të Ballkanit. Po të njejtët miq ishin me ne edhe gjatë rimëkëmbjes së pasluftës, rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta dhe okupimi.

Sot, kujtojmë shumë sakrifica që i kanë paraprirë kësaj dite të jashtëzakonshme. I kujtojmë nënët dhe baballarët të cilët përjetuan vështirësi të papërshtkrueshme në mënyrë që bijtë dhe bijat e tyre të mund të jetonin të lirë. Sot, kujtojmë Presidentin Ibrahim Rugova, udhëheqësin e madh dhe themeltarin e shtetit tone, i cili e nxorri Kosovën nga kaosi në rend demokratik. Sot, kujtojmë Adem Jasharini dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që e çuan tutje vullnetin e popullit të Kosovës për të qenë të lirë. Poashtu kujtojmë edhe fqinjëtë tanë të të gjitha përkatësive etnike, ideologjike e religjioze të cilët na dolën në ndihmë gjatë viteve të repressions dhe luftës. I kujtojmë të gjitha këto jo në shenjë hakmarrjeje për të kaluarën e dhunshme, por për të ndërtuar një të ardhme plot besim që do të ofrojë ambient për pajtim dhe falje.

Këto ngjarje të madhërishme të historisë sonë sakrificat tona, si dhe shpresat dhe arritjet tona na kanë sjellë sot këtu për të shpallur pavarësinë tonë. Kjo shpallje e pavarësisë është vullnet i popullit. Është rrjedhojë morale dhe logjike e historisë sonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekondimet e të Dërguarit Special Marti Ahtisari. Pavarësia e Kosovës shënon fundin e procesit të gjatë të shpërbërjes së Jugosllavisë. Pas dy vitesh angazhimi në negociata të mirëfillta mbi statusin me Beogradin dhe përkundër angazhimit serioz dhe konstruktiv të Ekipit të Unitetit të Kosovës, arritja e një zgjidhjeje të pranueshme për dy palët nuk ishte e mundshme. Prandaj, u desh të vepronim për t'i ofruar popullit tonë një perspektivë të qartë me qëllim të avancimit të zhvillimit tonë politik, shoqëror dhe ekonomik.

Vizioni ynë për Kosovën është shumë i qartë. Dëshirojmë që Kosovën ta ndërtojmë mbi parimet fundamentale demokratike. Kjo do të thotë se Kosova do të jetë një shtet demokratik, shumetnik, i integruar në rajon, me marrëdhënie të mira fqinjësore me shtetet përreth, një shtet që lëviz shpejt drejt anëtarësimit të plotë në Bashkësinë Euro-atlantike. Populli i Kosovës është përcaktuar dhe dëshiron një të ardhme evropiane për vendin e vet.

Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës në mars të vitit të kaluar ka marrë edhe përkrahjen e Kuvendit të Kosovës. Kjo pako u jep serbëve por edhe pakicave tjera: turqve, boshnjakëve, romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve, garancë të fuqishme për mbrojtjen e të drejtave të tyre kulturore e politike, që në shumë pika tejkalojnë edhe standartet më të avancuara ndërkombëtare për të drejtat e pakicave. Kushtetuta e Republikës së Kosovës u garanton komuniteteve pakicë pjesëmarrje të gjithanshme dhe kuptimplotë në vendimmarrje.

Të nderuar pjesëmarrës të kësaj seance historike të Kuvendit të Kosovës,

Prioritet nacional për Republikën e Kosovës në javët dhe muajt e ardhshëm është zbatimi i plotë i Planit të Ahtisarit. Shumë shpejt synojmë të miratojmë ligjet dhe Kushtetutën e re të Kosovës e cila mishëron edhe parimet e Ahtisarit. E gjithë kjo do të pasohet me veprime konkrete në terren për zbatimin e dispozitave që përmban plani i Presidentit Ahtisari.

Kosova me aktin e sotëm poashtu po merr përgjegjësitë që i takojnë si shtet. Në të njëjtën kohë, Kosova rithekson përkushtimin për bashkëpunim të ngushtë me Bashkësinë Ndërkombëtare për ndërtimin e një shteti në pajtim me normat dhe parimet më të avancuara të demokracisë. Për këtë qëllim Kosova mirëpret vendosjen e pranisë civile ndërkombëtare, e cila do të mbështesë zhvillimin e mëtejshmë demokratik të vendit tonë por, edhe do të mbikëqyrë zbatimin e Planit të Ahtisarit. Në veçanti, vlerësojmë gatishmërinë e BE-së për të marrë një rol më të madh në Kosovë. Poashtu mirëpresim vazhdimin e pranisë ushtarake të trupave të NATO-s. Zotohem se do të bashkëpunojmë ngushtë me përfaqësuesit civilë dhe ushtarakë në Kosovë.

Jemi të vetëdijshëm se pjesëtarë të komuniteteve pakicë në Kosovë e shikojnë pavarësinë me frikë dhe skepsë. Ne do të bëjmë çmos që të sigurohem se të drejtat, kultura dhe prona e tyre do të respektohen në mënyrë rigorozë në Kosovën e pavarur.

Poštovani gradjani Kosova,
Poštovani poslanici,

Još jednom želim da iskoristim ovu svečanu priliku da ponovo pozivam sve gradjane Kosova, pre svega gradjane srpske zajednice na Kosovu da daju svoj doprinos u zajedničkoj izgradnji jednog Evropskog Kosova u kojem svaki gradjanin će se osećati u svojoj kući. Kosovo je podjednako vaša kuća i vaša domovina. Vaša prava i prava pripandika drugih zajednica u nezavisnom Kosovu biće stalna obaveza naših državnih intitucija. Srpsko kulturno i religiozno nasledje biće potpuno zaštićeno. Vas etnički i jezični identitet biće potpuno poštovan. A to ćemo ostvariti zajedničkim radom u svakodnevnom životu i u institucijama Kosova.

Të nderuar deputetë,

Duam të theksojmë fuqishëm se Kosova dëshiron marrëdhënie të fqinjësise së mirë edhe me Serbinë mbi bazën e respektimit të ndërsjellë. Shpresojmë se synimi ynë për të normalizuar marrëdhënet me Beogradin sa më shpejt që të jetë e mundur do të përkrahet edhe nga Serbia.

Jemi mirënjoyës për rolin dhe punën që ka bërë OKB-ja në rindërtimin e Kosovës së pasluftës. OKB-ja do të vazhdojë të luajë një rol në Kosovë për aq kohë sa Rezoluta 1244 do të jetë në fuqi. Do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me OKB-në për të avancuar qëllimet tona të përbashkëta për paqe, siguri dhe zhvillim

demokratik të Kosovës deri në anëtarësimin e plotë të Kosovës në këtë organizatë prestigjioze.

Integrimi ynë do të rrjedhë natyrshëm sepse me vlerat e veta Kosova kulturalisht i ka takuar kësaj familjeje gjithnjë, por tashti në rrethanat e reja Kosovës i duhet integrimi politik për të krijuar mundësi të reja në mënyrë që resurset njerëzore dhe natyrore të vihen në shërbim të zhvillimit të gjithanshëm shoqëror e ekonomik të vendit tonë.

Zonja dhe Zotërinj,

Republika e Kosovës sot kërkon përqafimin e botës. Ndërsa presim njohje të shpejtë nga shumë vende të botës, me pietet të veçantë kujtojmë shumë personalitete të mëdha botërore që qëndruan përkrah popullit të Kosovës gjatë dekadave e sidomos gjatë orëve më të vështira të tij.

Populli ynë do të dijë t'u jetë përjetësisht mirënjojës Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të Bashkimit Evropian, NATO-s dhe vendeve të tjera të botës demokratike për përkrahjen e pazëvendësueshme për vendin tone, Kosovën.

Zoti e bekoftë popullin e Kosovës!

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës!

Zoti i bekoftë të gjithë miqtë e Kosovës!



Miratohet Deklarata e Pavarësisë, 17 Shkurt 2008



Presidenti Sejdiu viziton foshnjën e parë të lindur në Kosovën e Pavarur.
Familja e saj e pagëzoi me emrin Pavarësia



Presidenti duke u nënshkruar në Obeliskun e Pavarësisë



Presidenti duke folur në Koncertin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës
Në prapavijë Filarmonia e Kosovës

Fjala e Presidentit Sejdiu në koncertin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës

Prishtinë, 17 shkurt 2008; Salla 1 Tetori

Inderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi,
Inderuar kryeministër i Kosovës, z. Hashim Thaçi,
Të nderuar deputetë e ministra të Kuvendit të Kosovës,
Enderuara familje e Presidentit Rugova,
Enderuara familje Jashari,
Të nderuara familje të dëshmorëve të Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve të vendit,
Të nderuar përfaqësues të misioneve diplomatike në Kosovë,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotérinj,

Po flas para jush si President i Republikës së Kosovës të shpallur pasditen e sotme, kësaj të diele të 17 shkurtit të vitit 2008.

Sic e thashë sot në fjalën time në Kuvend, dita e sotme e ndan historinë e Kosovës në dysh; në epokat para dhe pas pavarësisë. Pavarësinë e Kosovës e kanë

krijuar breza të tërë heronjesh të kënduar e të pakënduar me veprën e tyre jetësore, me punën e palodhshme e sakrificat që kanë bërë. Pavarësinë e shpallëm para botës ne, populli i Kosovës, afër dy milionë e gjysmë njerëz, përmes përfaqësuesve të popullit, të deputetëve të kësaj legjislature, tash të Republikës së Kosovës, ngritën dorën në mbështetje të Deklaratës së Pavarësisë. Mëvetësinë tonë e shpallëm para botës dhe me bekimin e saj, në mes miqësh tanë, që u gjetën pranë nesh para një dekade, kur e keqja kishte përlarë këtë pjesë të Ballkanit, por edhe më vonë, në këto vite të rimëkëmbjes së jetës shoqërore, ekonomike e politike të vendit tonë të shkatërruar nga okupimi e lufta. Në këtë fillim të shekullit të ri, të mileniumit të tretë, po hyjmë në familjen e madhe, në gjirin e kombeve të lira të botës, me pavarësi si të barabartë.

Për t'u bërë shtet më vete, kombi në kuptimin politik të fjalës, Kosova ka kaluar nëpër histori përpjekjesh e vuajtjesh gjatë ekzistencës së vet, shpeshëherë në luftë për identitet politik, kulturor e historik si entitet më vete. Perandori të mëdha e të vogla prej antike e këndejanë ngritur, kanë lulëzuar, e kanë rënë, ndërsa Kosova si Dardani antike apo si njësi me identitet të veçantë përgjatë historisë ka ruajtur substancën e vet me bazë shumicën parashqiptare e shqiptare, dhe me pakicat etnike, që kanë jetuar këtu nëpër shekuj përgjatë evolucionit historik të kësaj hapësire gjeografike e politike.

Pavarësinë e Kosovës e shpallëm sot, kur sapo janë mbushur dy vjet nga vdekja e Ibrahim Rugovës, burrit më të madh të Kosovës, themeltarit të shtetit tonë. Rugova, Ati i Kombit tonë, në kuptimin politik të fjalës, dhe Adem Jashari, komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që mbush muajin tjetër 10 vjet të jetës në amshim, pasi ra në altarin e lirisë në Prekaz, përbëjnë binomin e pandashëm të pavarësisë së Kosovës. Ibrahim Rugova e nxori Kosovën prej kaosit në organizim, me rend të brendshëm demokratik e me struktura elementare shtetërore, deri edhe me përfaqësim diplomatik në bërthamë. Me këto dhe veprime të tjera ai ngriti dhe promovoi kulturën shtetformuese të Kosovës. Veprimi dhe organizimi kanë qenë palca kurrizore e aksionit politik të Ibrahim Rugovës, të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), të lëvizjes më të organizuar shtetformuese që kanë pasur shqiptarët në historinë e vet moderne, amën e shtetit të Kosovës dhe të pluralizmit politik të vendit tonë, dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), organizimit më të suksesshëm të vullnetit luftarak të popullit tonë për liri dhe mëvetësi. Veprimtaria e lëvizjes politike që drejtoi Rugova ka qenë vetë lufta totale politike me organizim, i cili ka shtruar rrugën për të mbamen: për luftën me armë për liri e për ekzistencë njerëzore e nacionale, emblemë e përjetshme e së cilës mbetet komandanti Adem Jashari.

Cfarë shteti të Kosovës po krijojmë? Nëse jo në versionin idealist të Rugovës, të ideologut të pavarësisë së Kosovës, e të luftëtarëve me armë, shteti më i ri në Evropë e në botë po ndërtohet mbi themelet që kishte vënë Republika e Kosovës, e ngjyer me sakrificën e brezave e me gjakun e reth 15.000 kosovarëve që ranë në altarin e lirisë në fund të shekullit të kaluar, para më pak se një dekade. Kjo Kosovë është shtëpi e të gjithëve, e shqiptarëve shumicë dërmuese dhe e të

gjitha komuniteteve pakicë, duke përfshirë edhe serbët, me paqe të brendshme e raporte miqësore me fqinjtë, pjesë e Unionit Evropian dhe NATO-s dhe me marrëdhënie speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Kosova do të gjendet prej sot në hartën politike të botës. Synimi historik i popullit të Kosovës u realizua. Ëndrra jonë shekullore u bë realitet. Ne marrim atributet e nderit, por edhe përgjegjësitet që i takojnë shtetit, pas një ndërmarrjeje shtetformuese shumë të veçantë që e bën rastin e Kosovës sui generis. Këto përgjegjësi i marrim para të gjithë qytetarëve tanë, por edhe para bashkësisë ndërkombëtare. Tash vazhdonjeta me sprovat e ditëve, të javëve, të muajve, të viteve, e të dekadave që ka përparrë ky brez i njerëzve tanë, i shtetasve të Republikës së Kosovës, që kanë fatin të janë bashkëkohës të shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë. Ne besojmë se trashëgimtarët tanë do të kenë arsyë të ndihen krenarë me paraardhësit e vet, me vizionin e tyre për jetën e re të kombit tonë, me shpirtin e tyre fisnik, me frymën e tyre të paqes, të farkuar në vazhdën e stuhive barbare, të mizorive e të krimeve të luftës që prodhoi e keqja e fundshekullit të XX.

Kosova shtet po lind sot me ode gjëzimi për shumicën dërrmuese të popullit tonë. Mirëpo, duhet pranuar se një pjesë e bashkëqytetarëve tanë, e shtetasve të Republikës sonë të re, nuk e kanë pritur lindjen e këtij shteti me entuziazëm. Disa e kanë pritur edhe me drojë. E bëjmë të qartë dhe e themi zëshëm dhe solemnisht: Liria jonë do të jetë e të gjithëve! Liria jonë s'mund të jetë kërcënëm për askë, aq më pak për bashkëqytetarët tanë. Kësaj lirie të përbashkët i kërcënohen vetëm paragjykimi i atyre që e kanë parë shoqërinë tonë nga prizmi i dominimit. Kosova e re është arenë e barazisë së të gjithëve, jo e dominimit të askut mbi askë. Kjo është besa jonë, e njerëzve të mirë të Kosovës dhe e institucioneve të saj, që do të shenjtërohet edhe me Kushtetutën e Republikës, e cila do të miratohet nga Kuvendi pas disa javësh. Bashkë me Kushtetutën dhe krahas me të do të miratohet edhe korpusi i ligjeve që përplotëson kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, që, sipas nenit të parë të Kushtetutës së saj, është "shtet i pavarrur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm". Një pjesë e këtij korpusi tashmë është miratuar nga legjislatura e përparshtme e Kuvendit. Kjo dëshmon se përkushtimi i kosovarëve për këtë rend të ri të brendshëm të Kosovës nuk determinohet nga përbërja e një legjislature, apo e një Qeverie të Kosovës. Ky përkushtim është më i madh se rezultati i stinëve politike, i cikleve demokratike, nëpër të cilat do të kalojë Republika jonë.

Republika e Kosovës do të kërkojë kulm të ri në Unionin Evropian dhe në NATO. Integrimi ynë do të shkojë natyrshëm sepse me vlera të veta, Kosova kulturalisht bën pjesë në këtë familje që moti. Tashti na duhet edhe integrimi politik për të siguruar mundësi që potencialet njerëzore e materiale të vendit tonë të vihen në shërbim të zhvillimit të gjithanshëm shoqëror e ekonomik të vendit tonë.

Pavarësia e Kosovës e bën të mundshme pjesëmarrjen e vendit tonë në proceset ekonomike globale, të cilat shkojnë nëpër bashkëpunime rajonale dhe multilaterale fillimisht. Vendi ynë do të krijojë mundësi për jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e vendit, sepse shteti ynë do të jetë partner sovran në marrëdhëni me të tjerët, në mbrojtje të vlerave e të qytetarëve të vet, duke respektuar dhe promovuar vlerave universale në udhën e progresit për të gjithë.

Institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës IPVQ, siç janë quajtur me një akronim jo fort kumbues Republika i shndërron në institucione të përkohshme që s'do të quhen të përkohshme, por as të përhershme. E përhershme është tani vetëm Republika është liria e Kosovës.

E përjetshme qoftë Republika e Kosovës! Sot e për mot një ode gjëzimi për ne vdektarët, për kalimtarët e kësaj bote.

Republika e Kosovës kërkon përqafimin e botës.

Ju falemnderit!
Presidenti i Kosovës

Dr. Fatmir Sejdiu



Presidenti i Republikës ndan gjëzimin me Qytetarët e Kosovës në Sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë.



Presidenti Sejdiu duke nënshkruar kërkesën për njohjen e Pavarësisë së Kosovës

Kronologji e fillimit të njohjes së Republikës së Kosovës

Më 18 shkurt 2008, një ditë pasi Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e vendit, nisi njohja zyrtare e shtetit më të ri të Evropës dhe të botës Republikës së Kosovës.

Përfaqësuesit nga Britania e Madhe, Franca, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia dhe Shqipëria, sollën në orët e pasdites letrat e njohjes së shtetit tonë dhe akreditimet përvendosjen e marrëdhënieve dypalëshe diplomatike në nivel ambasadash. Përfaqësuesit e zyrave të deritanishme ndërlidhëse të këtyre vendeve, sollën me radhë akreditimet që kanë marrë nga Londra, Parisi, Uashingtoni, Ankaraja dhe Tirana, për të krijuar marrëdhënie të reja me Kosovën. Britaniku David Blant, francezja Delphine Borione, amerikania Tina Kaidanow, turku Mustafa Sarnic dhe Arben Çeku do të kujtohen në historinë e Kosovës si përfaqësuesit e parë të shteteve që zyrtarisht bekuan shtetin e ri të Kosovës. Në ceremonitë e organizuara në këtë ditë të shënuar, Presidenti i Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, dhe kryeministri Hashim Thaçi kanë ripohuar se Kosova është e përkushtuar në rrugën e saj të ndërtimit të një shteti demokratik, në të cilin të gjithë qytetarët do të jetojnë të lirë dhe të barabartë, pa dallim etnie a besimi. "Me këto letra formalisht konfirmojnë vullnetin e Mbretërisë së Bashkuar përvendosje së Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran, zyrtarisht të vendosë marrëdhënie diplomatike në mes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës dhe rrjedhimisht të

ndërrojë statusin e Zyrës Britanike në Ambasadë Britanike", tha ambasadori David Blant. Presidenti i Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu e ka quajtur këtë akt një moment historik përvendosje së Kosovës, Delphine Borione, solli letrën e njohjes dhe akreditimin përvendosje së ambasadës, që nga liderët e Kosovës u pranua me shumë kënaqësi. "Eshtë një etapë e re e raporteve mes Francës dhe Kosovës dhe shpresojmë të zhvillojmë bashkëpunim ekonomik, kulturor e universitar edhe më tej. Jemi të bindur se pavarësia do t'i kontribuojë stabilitetit në rajon", tha ambasadorja Borione. Pas ambasadores franceze, në Presidencë ka arritur shefja e Zyrës Amerikane në Prishtinë, Tina Kaidanow. Ajo i ka dorëzuar Presidentit Sejdiu letrën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, George W. Bush, nëpërmjet së cilës Presidenti Bush, në emër të popullit amerikan, shpall botërisht se e njeh Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Të njëjtën procedurë kanë ndjekur edhe shefat e zyrave të deritanishme ndërlidhëse të Turqisë dhe të Shqipërisë, z. Sarnic përkatësisht z. Çeku, të cilët tanimë janë përfaqësues të ambasadave të këtyre vendeve në Kosovë.

Vijon të shtohet numri i vendeve të cilat njohin pavarësinë e Republikës së Kosovës

Presidenti George W.Bush: Në emër të popullit amerikan, unë njoh Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, George W. Bush, i ka dërguar një letër Presidentit Sejdiu, me të cilën e njoftoi atë se SHBA-të e njohin Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Më poshtë, po e japim në tërësi këtë letër.

18 shkurt 2008
Inderuari zoti President,



Në emër të popullit amerikan, unë njoh Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Ju përgëzoj Ju dhe qytetarët e Kosovës që keni marrë këtë hap të rëndësishëm në zhvillimin tuaj demokratik dhe kombëtar.

Në këtë rast historik, unë përkujtoj lidhjet e thella dhe të sinqerta të miqësisë që bashkojnë njerëzit tanë. Kjo miqësi, e farkuar gjatë orëve më të errëta të tragjedisë së Kosovës, është bërë edhe më e fortë në nëntë vitet që kur ka

mbaruar lufta në Kosovë. Prej asaj kohe, Kosova ka punuar për ta rindërtuar shoqerinë e shkatërruar nga lufta, për të ngritur institucionet demokratike, për të mbajtur zgjedhje të sukseshme për një qeveri të re, dhe për të avansuar prosperitetin.

Si shtet i pavarur Kosova tash merr përgjegjësi përfatim e vet. Si edhe në të kaluarën, Shtetet e Bashkuara do të janë partneri juaj dhe miku juaj.

Në kërkesën tuaj përfatim marrëdhënie diplomatike me Shtetet e Bashkuara, ju keni shprehur dëshirën e Kosovës përfatim arritur standardet më të larta të demokracisë dhe të lirisë. Unë e mirëpres këtë ndjesi. Në veçanti unë mbështes përfqafimin nga ana juaj të multienticitetit si parim të qeverisjes së mirë dhe përkushtimin tuaj përfatim zhvilluar institacione të përgjegjshme, në të cilat të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit.

Po ashtu unë veneroj se në deklaratën e vetë të pavarësisë Kosova me vullnet të vetin ka marrë përgjegjësitë që i përshkruhen në bazë të Planit të Ahtisarit. Shtetet e Bashkuara mirëpresin këtë angazhim të pakusht përfatim përmbytjet e përgjegjësia si dhe gatishmërinë e Kosovës përfatim bashkëpunuar plotësish me bashkësinë ndërkombëtare gjatë periudhës së mbikëqyrjes ndërkombëtare, përfatim cilën keni rënë dakord.

Shtetet e Bashkuara mbështeten në garancat e Kosovës se ajo e konsideron veten juridikisht e obliguar t'u përbahet dispozitave që përban Deklarata e Pavarësisë së Kosovës. Jam i bindur se miratimi i plotë dhe me kohë i masave të propozuara nga Emisari Special përfatim Kosovë, Ahtisari, do ta sjellin Kosovën më afër përbushjes së aspiratave të saj evro-atlantike.

Në bazë të këtyre garancave nga Qeveria e Kosovës, me kënaqësi e pranoj kërkesën tuaj që dy vendet tona të vendosin marrëdhënie diplomatike. Shtetet e Bashkuara do të mirëpresin vendosjen e përfaqësisë diplomatike të Kosovës në SHBA dhe planifikon vetë që ta bëjë të njëjtën në Kosovë.

Teksa Kosova po hap një kapitull të ri në historinë e vet si shtet i pavarur, pres me gëzim thellimin dhe forcimin e miqësisë sonë të veçantë.

*Shkëlqesisë së Tij
Fatmir Sejdiu
President i Kosovës
Prishtinë*

*Përzemërsisht,
George W. Bush*



Më 18 shkurt 2008 Presidenti Sejdiu pranon Letrën e njohjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës



Presidenti Sejdiu pranon Letrën e njohjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës nga Anglia.



Presidenti Sejdiu pranon Letrën e njohjes ndërkombëtare
të Republikës së Kosovës nga Franca



Presidenti Sejdiu pranon Letrën e njohjes ndërkombëtare
të Republikës së Kosovës nga Republika e Shqipërisë



Presidenti Sejdiu pranon Letrën e njohjes ndërkombëtare
të Republikës së Kosovës nga Turqia





Të gjithë për Pavarësi !



Fishekjarret gjatë kremitimit të Pamvarësisë



Stema dhe Flamuri i Republikës së Kosovës